



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arkiva - Archive

Nr. Org. 02 m/f
Org. Jedin. Org. Unit
Nr. i fazeve
Broj faza
H. pagjet:
Hyrëse

Nr. Prot. 2406-1/2023
Pr. Prot.
Data 13.11.2023
Datum
Date:
PRISHTINE/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Gllogocit
	Milaim Hajdari , Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Jeton Qela , ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
	Enis Spahiu , ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Bora Duli , ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Razije Murtezaj , Zyrtares Ligjore, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj , Zyrtares e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Gllogocit
Lloji i aktit:	Vendim



Referencë:
278/2023

I nderuari Kryetar z. Lladrovci,
I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimi 02 Nr. 400/53519 për ndarjen e kapitalit themelor për NPL" Stacioni i Autobusëve"</i>
<i>SH.A- Glllogoc</i>
<i>I miratuar më 27.10.2023</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 30.10..2023</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 01.11.2023</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërme të Komunës së Glllogocit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Glllogocit, me anë të vendimit që është subjekt i shqyrtimit, synon ndarjen e kapitalit themelor për NPL Stacioni i Utobusëve" SH.A- Glllogoc , shuma prej 10 ,000 euro.
2. Përkundër faktit se Komunave iu jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuar me nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Komunitat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP") dhe Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

Neni 7

Burimet Financiare Komunale

7.2 Komunitat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFPP gjatë disponimit me këto burime financiare.

3. Ajo që i faktorizon edhe më shumë detyrimet e përcaktuara me dispozitat e LMFP-së është neni 81 i LMFP-së, në të cilin precizohet që në rastet kur ky ligj ka mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, dispozitat e LMFP-së kanë përparësi, sikurse përshkruhet më poshtë:

Neni 81

Hyrja në fuqi/Shfuqizimi i legjislacionit paraprak/Zbatueshmëria



81.1. Në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë publike, **dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të kenë përparësi, në pajtim edhe me nenin 36 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. [theks i shtuar]**

4. Në rrjedhë të kësaj, LMFP konsiderohet ligj organik që përcakton kushtet, procedurat dhe konditat ligjore për menaxhimin e mirëfillt të financave publike në përgjithësi, dhe shpenzimin e parasë publike në veçanti.
5. Në kuptim të shpenzimit të rregullt të parasë publike, neni 17 i LMFP-së precizon qartë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe të shpenzohen nga **fondet e ndara dhe të alokuara [theks i shtuar]**.
6. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin me Nr. 08/L-213 dhe Ligjit me Nr.08/L-235 , si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Glllogocit, ku është evidentuar se komuna i ka të planifikuara shpenzimet e potencuar me aktin komunal për këtë vit fiskal sipas nën-programit përkatës.
7. **Si përfundim, dhe duke marrë për bazë konstatimet e mësipërme, akti administrativ i Komunës së Glllogocit është në përputhje me legjislacionin në fuqi.**

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Glllogocit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministurtstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, U. d Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
Kopje:	Kryetar i Komunës së Glllogocit Kryesuesi i KK - Glllogoc Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Jeton Qela, U. d Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	Besim Myrtezani, U. d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës 2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse
Lënda:	Shkresë përcjellëse në MFPT
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar: Vendimin 02 Nr. 400/01-53519 për ndarjen e kapitalit themelor për NPL "Stacioni i Autobusëve" SH. A - Glllogoc, i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale. Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 02 Nr. 400/01-53519 për ndarjen e kapitalit themelor për NPL "Stacioni i Autobusëve" SH. A - Glllogoc

I miratuar më datë: 27.10.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.10.2023



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/04-53519 dt. 27.10.2023



Kuvendi i Komunës së Drenasit		
Data: 30.10.2023		
Numri i Aktit	Numri i Dokumentit	Numri i Votës
-41-	020-839	

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në bazë të nenit 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ligjin nr. 04/L-111 për ndryshim plotësimin e ligjit nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, Vendimin nr. 02-020-49438 dt. 22.09.2022 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL Stacioni i Autobusëve SH.A-Drenas, nenin 11 të Statutit të NPL Stacioni i Autobusëve "SH.A-Drenas me nr. 02-030/01-30488 i dt. 24.06.2022, si dhe Certifikatës së regjistrimit në ARBK me nr. 812094209 e dt. 25.10.2023 dhe nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit i dt. 16.09.2008, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: 27.10.2023, miratoi këtë:

VENDIM
PËR NDARJEN E KAPITALIT THEMELOR PËR NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE"
SH.A.- DRENAS

Neni I

Më këtë Vendim ndahet kapitali themelor në vlerë prej: 10,000.00 € për ta ndihmuar Ndërmarrjen Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A-Drenas, për funksionalizimin fillestar të saj.

Neni II

Shuma e mjeteve si në pikën I të këtij vendimi ndahen pasi që komuna e Drenasit është pronare e Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A. - Drenas me 100% aksione në pronësinë e sajë.

Neni III

Mjetet financiare ndahen nga buxheti i komunës së Drenasit-Kodi buxhetor i subvencioneve të DShPE-së.
NLP "Stacioni i Autobusëve në Drenas" SHA si përfitues i (subvencioneve) ndihmës financiare, obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojë Raportin me të gjitha shpenzimet financiare.

Neni IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i komunës, ndërsa për monitorimin e zbatimit kujdeset Kryesuesi i KK. Drenasit dhe Komisioni Komunal i Aksionarëve.

Neni V

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ilir Hajdari

ARSYETIM

Duke pasur parasysh se Ndërmarrjen Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A-Drenas, e cila ka plotësuar kriteret e ligjshmërisë për themelimin e saj, si dhe duke u mbështetur në nenin 11 të Statutit të Ndërmarrjen Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A.-Drenas, ndahet kapitali themelor në vlerë prej 10,000.00€ për ta ndihmuar Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve SH.A-Drenas", për funksionalizimin fillestar të saj. Të gjitha ndryshimet e kapitalit themelor, bëhen sipas ligjit Nr.06/L-016, Shoqërinë Tregtare, prandaj kërkojmë aprovimin për ndarjen e mjeteve të lartë shënuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit.

